



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 67, Datë 03.03.2023

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 257, DATË
21.12.2021 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “YILDIRIM ENERGY EUROPE
ALBANIA” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 120/4 prot., datë 01.03.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 257 datë 21.12.2021 “Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” dhe “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 258 datë 21.12.2021 “Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 257, datë 21.12.2021, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke i lënë kusht asaj që të depozitojë në ERE strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj, në përputhje me ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
- Pas sqarimeve dhe korrespondencës përkatëse të zhvilluar mes shoqërisë dhe ERE-s, në lidhje me plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 257/2021, rezulton se ajo e ka plotësuar tashmë këtë kusht.
- Duke qenë se është plotësuar kushti i vetëm i vendimit nr. 257/2021, nuk gjen më zbatim as pika 3, që ka të bëjë me të drejtën e ERE-s për rishikimin e këtij vendimit.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 2 dhe pikën 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2021 “Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI